

"Take Care"

New York City Test and Trace Corps

Janar 2021

Përmbledhje e "Take Care"

"NYC Test & Trace Corps" do të sigurohet që të gjithë ata që rezultojnë pozitiv me COVID-19 dhe personat e ngushtë me të cilët ata kanë kontakt të disponojnë burimet e nevojshme për t'u izoluar në mënyrë të sigurt dhe falas **në një hotel apo në shtëpi** për të ndihmuar në parandalimin e përhapjes së virusit.

Informacione se si të izoloheni në mënyrë të sigurt në një hotel të "Take Care"

- Njujorkezët që rezultojnë pozitiv me COVID-19 ose që mund të jenë ekspozuar ndaj virusit mund të kualifikohen për një dhomë hoteli FALAS deri në 10 ditë për t'u izoluar në mënyrë të sigurt dhe për të mbrojtur të afërmit dhe miqtë e tyre.
- Nëse zgjidhni të izoloheni në një hotel të "Take Care", për këtë nuk do të zbatohet rregulli i barrës publike dhe kjo nuk do të ndikojë në asnjë nga përfitimet që merrni. Hotelet e "Take Care" nuk do të ndikojnë në mundësinë për të aplikuar për kartë jeshile.
- Për më tepër, NUK do të zbatohet rregulli i barrës publike për shërbimet e kujdesit mjekësor ose shërbimet shëndetësore parandaluese të lidhura me COVID-19.
- **Çdokush mund të telefonojë në numrin 1-212-COVID19 (212-268-4319) për të rezervuar një dhomë.**

Informacione se si të izoloheni në mënyrë të sigurt në një hotel të "Take Care"

- Klientët e hotelit do të disponojnë FALAS:
 - Transportin vajtje-ardhje për në hotel dhe për çdo vizitë të nevojshme mjekësore
 - Dhomë dhe tualet personal
 - Testim në vend për COVID-19
 - Wi-Fi, televizion kabllor dhe telefonata pa kufi brenda vendit për të qëndruar në kontakt, të gjitha falas
 - Mëngjes, drekë dhe darkë për çdo ditë (përfshihen ushqime vegjetariane dhe kosher)
 - Dërgesa të barnave
 - Shërbime të kujdesit shëndetësor në vend nga mjekë dhe infermierë të kualifikuar
 - Telepsikiatri për t'u lidhur me ekspertë të shëndetit mendor
- **Çdokush mund të telefonojë në numrin 1-212-COVID19 (212-268-4319) për të rezervuar një dhomë.**

Informacione se si të izolooheni në mënyrë të sigurt në një hotel të "Take Care"

- Gjeni më shumë informacione në:
<https://www.nychealthandhospitals.org/test-and-trace/take-care/>
- Çdokush mund të telefonojë në numrin 1-212-COVID19 (212-268-4319) për të rezervuar një dhomë.

Izolohuni në mënyrë të sigurt në shtëpi – Burimet

- "NYC Test & Trace Corps" do të sigurohet që kushdo që ka COVID-19 ose ka qenë në kontakt me dikë me COVID-19 të kenë burimet për t'u izoluar në mënyrë të sigurt në shtëpi.
- Për këtë, ne punojmë me punonjës të shqyrtimit të burimeve nga organizata komuniteti në lagjen tuaj.
- Ata mund t'ju ndihmojnë të lidheni me burimet në lagjen tuaj.

Izolohuni në mënyrë të sigurt në shtëpi – Burimet

Në burimet FALAS përfshihen:

- dërgimi i ushqimit
- leja e paguar nga punëdhënësi juaj
- ndihma për marrjen e një urdhri për t'u karantinuar
- barnat
- sigurimet shëndetësore
- shërbimet komunale (energji elektrike, ujë, gaz)
- një ofrues i kujdesit shëndetësor parësor
- mbështetja për shëndetin mendor
- ndihma në lidhje me dhunën në familje
- shërbimet sociale
- burimet e strehimit dhe akomodimit të të pastrehëve
- kujdesi për kafshët shtëpiake
- Paketa e "Take Care" me pajisje mbrojtëse personale të mjaftueshme që një familje me tre anëtarë të karantinohet/izolohet për 10 ditë.
- dhe shumë të tjera!

Izolohuni në mënyrë të sigurt në shtëpi – Burimet

- Ne punojmë me Organizata Komuniteti (Community-Based Organizations, CBO) për të kryer një shqyrtim të burimeve. CBO-të janë të organizuara më së miri për të kryer këtë detyrë, sepse ato:
 - I kuptojnë komunitetet vendase të cilave u shërbejnë
 - Kanë aftësitë gjuhësore që nevojiten më së shumti në komunitet
 - Kanë ekspertizë në burimet vendase, çka është jetike për të ofruar shërbimet e duhura gjithëpërfshirëse

Theksimi i burimeve – Sigurimi i ushqimit

Shërbimi i dërgimit të ushqimit në shtëpi për raste emergjente është i disponueshëm për njujorkezët në nevojë gjatë krizës së COVID-19 nëse:

- As ju dhe askush që ju njihni nuk mund të dalë dhe të marrë ushqime për ju
- Nuk mund të përballoni dërgimin e vakteve ose të produkteve ushqimore
- Opsionet e ushqimeve vegjetariane, kosher, hallall, latine dhe aziatike janë të disponueshme me kërkesë.

Për t'u regjistruar për dërgimin e ushqimeve për raste emergjente:

- Komunikoni me punonjësin e shqyrtimit të burimeve
- Telefononi **linjën telefonike të "Test & Trace Corps" në numrin 1-212-COVID19 (1-212-268-4319)**. Shtypni 5 për burimet dhe më pas shtypni 5 për të lënë një mesazh për punonjësin e shqyrtimit të burimeve. Një punonjës i shqyrtimit të burimeve do t'ju telefonojë dhe do t'ju ndihmojë me regjistrimin.
- Regjistrohuni në internet në faqen nyc.gov/getfood ose telefononi në numrin 311 dhe thoni "Get Food" (Merr ushqim).

Theksimi i burimeve - Paketa e "Take Care"

- Paketa e "Take Care" i ofrohet të gjitha rasteve dhe kontakteve.
- Ajo përfshin pajisje mbrojtëse personale të mjaftueshme që një familje me tre anëtarë të karantinohet për 10 ditë.
- Këtu përfshihen maska mjekësore, dezinfektues për duart, termometra dhe një oksimetër pulsi për të ndihmuar personat që rezultojnë pozitivë me COVID-19 që të monitorojnë nivelet tyre të oksigjenit.
- Kontaktet mundet që të kërkojnë edhe një paketë testimi në shtëpi.



Izolimi i sigurt në shtëpi – Si të lidheni me burimet?

- Nëse ju apo një anëtar i komunitetit tuaj është me COVID-19 ose ka qenë në kontakt me dikë me COVID-19, do të referoheni te një punonjës i shqyrtimit të burimeve.
- Kushdo mund të telefonojë në numrin 1-212-COVID19 (212-268-4319), të shtypë 5 për t'u izoluar i sigurt në shtëpi dhe 5 për të lënë një mesazh zanor për burime të tjera. Një punonjës i shqyrtimit të burimeve do t'ju marrë sërish në telefon.
- Mund të vizitoni faqen e internetit të Departamentit të Shëndetit dhe Higjienës Mendore (Department of Health and Mental Hygiene, DOHMH) për të gjetur burime specifike në të gjithë qytetin dhe lagjen në:
<https://www1.nyc.gov/site/doh/covid/covid-19-communities.page>

Diskutime dhe pyetje

NYC
HEALTH+
HOSPITALS



Dërgimi i metadonit

- Njujorkezëve që kanë rezultuar pozitivë me COVID-19 ose që mund të kenë qenë të ekspozuar ndaj virusit dhe janë në karantinë/izolim mund t'u ofrohet dërgimi i metadonit në hotel ose në shtëpinë e tyre. Shërbimi i dërgimit është gjithashtu i disponueshëm për personat e moshës 50 vjeç e lart dhe që vuajnë nga sëmundje bashkëshoqëruese që i bën ata të jenë më të rrezikuar për t'u sëmurur rëndë.
- Si të organizoni dërgimin e metadonit:
 1. Nëse jeni në karantinë/izolim në një hotel të "Take Care", një punonjës social do të organizojë dërgimin e metadonit në hotel.
 2. Nëse jeni në karantinë/izolim në shtëpi, një punonjës i shqyrtimit të burimeve mund të bëjë një rekomandim për të organizuar dërgimin e metadonit në shtëpinë tuaj. Gjithashtu mund t'i telefononi klinikës shpërndarëse të metadonit dhe t'i bëni me dije se keni nevojë për shërbimin e dërgimit në shtëpi.